



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 314 Prot.

Tiranë, më dt. 31.05.2018

VENDIM

Nr.283, dt. 31.05.2018

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, dhe VKM nr.280, dt.01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar me VKM nr.756, dt.26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 31.05.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të procedurave të legalizimeve për objektin “Shtesë anësore 2 kate në objekt ekzistues 2 kate në rr. “Abdyl Frashëri”, në Qendrën Historike Korçë, me subjekt aplikues Z. Thioma Mançi.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani